



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 291/2 Prot.

Tiranë, më 20 . 06 . 2023

V E N D I M

Nr. 110 , datë 20 . 06 . 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,² mori në shqyrtim ankesën me nr. 185 Regj., datë 01.12.2022, të shtetasit F. Ll kundër: Ministrisë së Kulturës, Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kombëtare dhe Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “përkatësisë në grup të veçantë³” dhe “çdo shkak tjetër⁴”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në parashtrimet e sjella pranë Komisionerit, subjekti ankues, informon Komisionerin lidhur me problematikën e tij, për të cilën shprehet se:

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri ose me akronimin KMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

³ Subjekti ankues bazuar në dokumentacionin e depozituar gëzon statusin e të përndjekurit politik, si dhe provon faktin se ka qenë i dënuar e dëbuar për çështje politike, nga viti 1983-1988, sipas Vendimit të Komisionit Qendror të Internim Dëbimeve me nr. 12, datë 05.11.1983

⁴ Konstatuar kryesisht nga Komisioneri, bazuar në statusin e veçantë ligjor që gëzon ankuesi si posedues banesës “Hamid Lluja”, shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë.

“Unë kam në pronësi një banesë e cila ka status të veçantë⁵ dhe mbrohet nga ligji. Shtëpia ime ka nevojë për ndërhyrje emergjente sepse si pasojë e hyrjes së shiut nga çatia rrezikohen disa piktura që janë në shtëpi. Kam bërë kërkesa të herë pas herë tek institucionet përkatëse, përfshirë Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër për të ndërhyrë për restaurimin e shtëpisë, qoftë edhe me paratë e mija por nuk më është dhënë leja përkatëse.

Bonusin e rijetësimit të banesave monument kulture në Shkodër, në dijeninë time e kanë fituar 2 persona që kanë banesat e tyre të klasifikuara si monument kulture i kategorisë së parë, sikurse banesa ime. Këta persona janë persona që banesën e tyre do e përdorin për qëllime fitimi, bujtinë apo hotel, ndërsa unë dua thjesht ta restauroj ose më saktë të ndërhyj tek çatia e cila është në rrezik për të dëmtuar rëndë shtëpinë dhe nuk dua ta shndërroj në biznes.

Duke qenë se shtëpia ka status të veçantë nuk më lejohet të ndërhyj vetë por duhet miratim i posaçëm nga shteti (përfshirë edhe fondet për këtë çështje) dhe mendoj se kjo situatë e vështirë dhe ky diskriminim më bëhet mua në mënyrë të qëllimshme nga ana e këtyre institucioneve pikërisht nisur nga historiku im dhe i familjes tonë, pasi njihemi si familje e cila ka qenë e përndjekur politikisht, dhe mosveprimi i autoriteteve shtetërore është i qëllimshëm në rastim tim”

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim të tij dhe të merren masa për restaurimin e banesës së tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

⁵ Mbështetur në Vërtetimin me nr. 89/1 prot., datë 01.04.2021 të DRTK Shkodër vërtetohet se banesa e ankuesit është me status pasuri kulture, Monument Kulture i kategorisë së parë, shpallur me Urdhëresën e datës 08.01.1977 të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga LMD.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 1539/1 prot., datë 13.12.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa⁶: Ministria e Kulturës (MK), Intituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK) dhe Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Shkodër.

➤ Në përgjigje të sa më sipër, nëpërmjet shkresës me nr. 6920/1 prot., datë 28.12.2022, Ministria e Kulturës, informon Komisionerin se:

“ “Banesa e Hamit Llujs” në Shkodër është shpallur Monument kulture, kategoria e I-rë, me Urdhëresë nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, datë 08.01.1977, për “një dhomë me tavan me rozetë në qendër të gdhendur; një trapazan me açik rafte, me një brez dritaresh sipër; dritaret janë të pikturuara ndërsa nga jashtë me motive të gdhendura”.

-
- ⁶ Informacion në lidhje me problematikën e paraqitur nga subjekti ankues.
 - Cilat janë masat e ndërmarra për verifikimin e zgjidhjen e saj? Kopje të akteve shkresore.
 - Kopje të korrespondencës shkresore të mbajtur me ankuesin, nëse ka.
 - Informacion se sa është numri i banesave në qytetin e Shkodrës që i përkasin të njëjtës kategori dhe me të njëjtin status të veçantë si banesa e ankuesit? Respektivisht edhe informacioni dhe të dhënat se cilët janë pronarët e tyre.
 - Sa prej tyre i janë nënshtruar rikonstruksionit gjatë 5 viteve të fundit si dhe gjatë vitit të fundit? Kopje të dokumentacionit përkatës.
 - Cila është procedura që ndiqet lidhur me rikonstruksionin/rijetësimin e një banese të shpallur Monument Kulture i Kategorisë së parë?
 - Cili është institucioni kompetent lidhur me verifikimin, nevojën e ndërhyrjes apo rikonstruksionit të banesës së ankuesit e cila gëzon statusin e banesës Monument Kulture të Kategorisë së Parë?
 - Cila është procedura e ndjekur prej jush, pas kërkesës së ankuesit për rikonstruksionin e banesës së tij? Kopje të dokumentacionit provues.
 - A është ngritur ndonjë komision nga DRTK Shkodër lidhur me vlerësimin e situatës së paraqitur nga ankuesi për verifikimin e problematikës së ngritur prej tij? Nëse po, kopje të procesverbalit të mbajtur, të relacionit teknik përkatës, apo çdo dokumentacioni tjetër provues të disponuar prej jush, lidhur me këtë fakt.
 - Si dhe çdo informacion ose dokumentacion tjetër që mendoni se i shërben sqarimit të çështjes.

“Banesa e Xhevdet Llujës” në Shkodër është shpallur Monument kulture, kategoria e I-rë, me Urdhëresë nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, datë 08.01.1977, për “një dhomë me tavan me të pikturuar me motive ornamentale; një trapazan i pikturuar, një sergjen, me një dollap i gdhendur”.

Të dyja këto dhoma janë në pronësi të ndryshme, por të ndodhura nën të njëjtën çati.

Është e rëndësishme të kuptohet se ky objekt është i përfshirë në listën e objekteve të trashëgimisë kulturore vetëm për vlerat e interiorit (tavaneve), ndërsa si objekt klasifikohet si një ndërtesë/objekt pa vlera të veçanta arkitekturore/historike.

Për këtë objekt z. Ll është informuar nga DRTK Shkodër, se ka dy projekte të miratuara me Vendim nga KKTKM, me nr. 149, datë 21.03.2018 “Restaurimi i banesës së Xhevdet Llujës” si dhe me nr. 271, datë 31.05.2018 “Ndërhyrje konservuese restauruese në pikturën murale dhe objektet e drurit të banesës së Xhevdet Llujës, Shkodër”, të cilat nuk janë zbatuar.

Ndërkohë, një nga bashkëpronarët e kësaj prone ka shprehur interes për të përfituar nga programi i “Bonusit të Rijetëzimit”, për të cilën, DRTK Shkodër ka hartuar projektin e ndërhyrjes, por që për shkak të problemit të pronësisë (të pandarë), nuk i përmbushi dot kriteret e aplikimit.

Një nga dokumentat më të rëndësishëm përse i përket aplikimit për përfitimin nga ky program, është dokumenti i azhurnuar i pronësisë (i rifreskuar) dhe nga korrespondenca midis ASHK Shkodër dhe DRTK Shkodër ka rezultuar se pronarët kanë një certifikatë bashkëpronësie (të pa rifreskuar), e cila ka penguar vijimin e procedurës së aplikimit në platformën e-albania, në varësi të së cilës duhet të lidhet edhe aktmarrëveshja mes tyre.

Për sa më sipër, ftohen të dy poseduesit (pronarët) e objektit që pikë së pari, të mund të zgjidhin me dakordësi ose me rrugë gjyqësore çdo konflikt që kanë mbi pronën, si dhe të marrin pranë ASHK Shkodër certifikatën e pronësisë përkatëse për secilën palë, pa të cilën nuk mund të avancojnë për aplikimin në sistem.

Së dyti, qytetarëve ju lind e drejta që referuar nenit 72, pikat 1,2,3, të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, të mund t’i drejtohen subjekteve të licensuara në fushën e projektimit me licencën përkatëse, në mënyrë që të hartojnë dhe të aplikojnë projektin e restaurimit në sportelin unik të KKTKM-së pranë Ministrisë së Kulturës.

Përse i përket procedurës për t’u përfshirë në financimet me buxhet të shtetit duke përfituar nga grantet e akorduara nga MK, të dy pronarët mund të aplikojnë për t’u bërë pjesë e programit të radhës të “Bonusit të Rijetëzimit”, i cili do të hapet me anë të thirrjeve publike nga MK”.

- *Shkresa me nr. 1731/1 prot., datë 15.11.2022, e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK), lidhur problematikën e subjektit ankues, ka të njëjtën pëmbajtje dhe ndan të njëjtin informacion si ai me shkresën sipërcituar, të MK.*

- Pasi u njoh me përgjigjen e MK, ankuesi, me datë 16.01.2023, ka depozituar prapësimet e tij, lidhur me shkresën e MK-së.

Ankuesi ka kundërshtuar argumentet e MK, duke parashtruar si më poshtë citohet:

“Së pari, shtëpia është krejtësisht monument kulture dhe jo vetëm pjesë të caktuara të saj. Në dosjen që gjendet në MK është cituar qartë se e gjithë shtëpia është monument kulture dhe mbart vlera historike.

Së dyti, në shkresë thuhet që kemi probleme pronësie, që nuk është e vërtetë dhe pse certifikata e pronësisë mund të mos jetë e azhornuar, kjo nuk do të thotë që në certifikatë nuk janë të përcaktuar bashkëpronarët si dhe nuk tregon që unë nuk kam të drejta pronësie mbi shtëpinë.

Gjithashtu aty thuhet që ka aplikuar për bonusin e rijetëzimit znj. Diana Lluja, që nuk e njoh si person, dhe një person me këtë emër nuk ekziston në fisin Lluja.

Nga ana tjetër, sipas MK, kjo trashëgimi kulturore duhet të lihet në mëshirë të fatit derisa të rregullohet certifikata e pronësisë, e cila mund të zgjasë shumë kohë.

Për të gjitha arsyet sipërcituar, unë kundërshtoj dhe nuk jam dakord me përgjigjen e Ministrisë së Kulturës”.

- Nëpërmjet shkresës me nr. 35/1 prot., datë 30.01.2023, DRTK Shkodër ka sjellë parashtrimet e veta në kuadër të sqarimit të pretendimeve të subjektit ankues, duke bashkëlidhur edhe një pjesë të dokumentacionit të kërkuar.

DRTK Shkodër, ndër të tjera, ka parashtruar se:

“...me datën 27.09.2022, referuar Urdhrit të brendshëm nr. 196, është bërë inspektimi i banesës “Hamit Lluja” nga specialistët e sektorit të Arkeologjisë, Artit, Arkitekturës dhe Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore (AAAMTK) të DRTK Shkodër dhe është mbajtur procesverbali i inspektimit, protokolluar me nr. 287/1 prot., datë 27.09.2022.

Inspektimi i banesës u bë vetëm nga jashtë, pasi sipas pretendimit të vetë z. Ll problem qëndron tek banesa ngjitur, po me status monument kulture i kategorisë së I-rë, banesa “Xhavit Lluja”.

Me shkresën me nr. 287/2 prot., datë 14.10.2022, DRTK Shkodër i është drejtuar IKTK për ngritjen e një grupi pune të përbashkët për vlerësimin e situatës, për ndërhyrje dhe hartimin e një projekti për këtë banesë.

Për banesën “Hamit Lluja”, nga ana e Ferid Lluja nuk është depozituar asnjëherë ndonjë kërkesë për ndërhyrje në këtë banesë ose depozituar pranë zyrave tona, si dhe në platformën e-Leje ndonjë projekt restaurimi nga një person i licencuar për ndërhyrje në pasuri kulturore, sipas parashikimit përkatës ligjor.

Ndodhur në këto kushte, pretendimi i tij se nuk i është dhënë leje për ndërhyrje restauruese “qoftë edhe me paratë e tij”, bie poshtë.

Në kërkesën e z. Ll të datës 14.07.2022, depozituar pranë zyrave të DRTK Shkodër, ai kërkon marrjen e masave për mbrojtjen e pasurisë kulturore “Banesa e Xhevdet Llujës” dhe jo për banesën “Hamit Lluja” siç është shprehur në ankesën drejtuar KMD-së.

Shkresës së z. Ll, DRTK Shkodër i është përgjigjur nëpërmjet shkresës me nr. 13/2 prot., datë 08.09.2022, ku e ka informuar se për pasurinë kulturore “Banesa e Xhevdet Llujës” rezultoi të jenë dy projekte të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve me nr. vendimi 149, datë 21.03.2018 “Restaurimi i banesës së Xhevdet Llujës”, si dhe me nr. 271, datë 31.05.2018 “Ndërhyrje konservuese – restauruese në pikturën murale dhe objekte e drurit të banesës së Xhevdet Llujës, Shkodër”, të cilat nuk janë zbatuar.

Sa më sipër, sektori i AAAMTK i DRTK Shkodër ka hartuar projektin e plotë të restaurimit në Maj të vitit 2022 për ndërhyrje në pasurinë kulturore “Banesa e Xhevdet Llujës”.

Qarku Shkodër ka të listuar 156 pasuri kulturore me status monument kulture të kategorisë së I-rë dhe të II-të, ku numrin më të madh e zënë banesat”.

DRTK Shkodër ka informuar KMD-në se, gjatë viteve të fundit ka ndërhyrë përse i takon banesave në këto pasuri kulturore:

- Mirëmbajtje banesa Mic Sokoli;
- Mirëmbajtje Shtëpia ku lindi Pashko Vasa;
- Punime mirëmbajtëse e restauruese banesa e Filip Çekës;
- Punime mirëmbajtëse banesa e Nazif Muka;
- Punime mirëmbajtëse Ismet Halili;
- Punime mirëmbajtëse Adem Demajt;
- Punime mirëmbajtëse Rrustem Kryekurtit;
- Punime mirëmbajtëse dhe restaurimi në banesën e Muhamet Shurdhës
- Punime mirëmbajtëse banesa e Xhevahire Çelës, duke i bashkëlidhur shkresës kopjen e kontratës së lidhur nga DRTK Shkodër me zbatuesin e punimeve për secalin rast sipërcituar.

DRTK Shkodër ka informuar KMD-në gjithashtu, se, procedura që ndiqet në lidhje me rikonstruksionin/rijetëzimin e një banese të shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë është duke ndjekur hapat si më poshtë:

- Hartimi i projektit bëhet nga vetë specialistët e DRTK Shkodër, por ka raste kur projektet hartohen edhe në bashkëpunim me specialistët e IKTK; fletët teknike të projektit ku janë të evidentuara zonat e ndërhyrjeve; relacionin teknik; specifikimet teknike; grafiku i punimeve dhe preventive që firmosen nga grupi i projektimit, ndërsa grafiku i punimeve dhe preventive firmoset nga tutullari i Institucionit.

- Aplikimi për miratimin e projektit të ndërhyrjes në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale bëhet përmes portalit e-albania, ku për procedimin e saj kërkohet edhe statusi juridik i pasurisë. Për pasurinë kulturore që po hartohet projekti, bëhet kërkesë pranë ASHK për statusin juridik të saj.
- Në rast kur pasuria rezulton në pronësi private, pas shqyrtimit të statusit juridik të saj, do të lidhet aktmarrëveshja ndërmjet pronarëve aktualë dhe DRTK Shkodër, si hapi i fundit përmbyllës i aplikimit për miratim në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale/ KKTKM.
- Në rast kur pasuria kulturore rezulton shtet, nuk ka një marrëveshje të tillë.
- Pas shqyrtimit të projektit, KKTKM merr vendimin për miratimin ose jo të projektit të dërguar për miratim, ose jep sugjerime për plotësime të mëtejshme të projektit, në rast se është e nevojshme.

Për pasuritë kulturore që gjenden nën administrimin e DRTK Shkodër, ku bën pjesë edhe banesa “Hamit Lluja” dhe banesa “Xhevdet Lluja”, është kjo e fundit institucioni kompetent referuar, nenit 31, të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, lidhur me zbatimin e procedurës për rikonstruksionin a restaurimin e banesës në fjalë.

2. Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj ankese, Komisioneri, nëpërmjet shkresës me nr. 291 prot., datë 20.02.2023, njoftoi dhe ftoi palët për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, pranë Zyrës së Komisionerit.
3. Bazuar në kërkesën për shtyrje të DRTK Shkodër, seanca dëgjimore u vendos të zhvillohej me datë 20.03.2023⁷, njoftim i cili iu komunikua edhe palëve nëpërmjet telefonit dhe e-mailit.

Seanca dëgjimore u zhvillua datën 20.03.2023, ora 10:00, me pjesëmarrjen e subjektit ankues, Ministrisë së Kulturës, përfaqësuar nga D. H dhe I. M, Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, përfaqësuar nga S. M dhe Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, S. K dhe F. M. (sipas autorizimeve përkatëse në emër të institucioneve respektive, depozituar në dosjen e subjektit ankues)

Gjatë seancës dëgjimore, palët në proces mbajtën të njëjtin qëndrim si ai i bërë i njohur para KMD-së shkresërisht, si dhe parashtruan të njëjtat argumente, të cilat do të shtjellohen edhe në vijim të këtij Vendimi.

- Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet emailit datë 17.05.2023, DRTK Shkodër, dërgoi pranë KMD-së informacionin si më poshtë citohet:

⁷ Data e komunikuar në njoftimin për seancë ishte data 07.03.2023.

“Sikurse kemi shpjeguar, projektet e miratuara të vitit 2018 për objektin pasuri kulturore “Banesa e Xhavit Llujs” nuk janë zbatuar për shkak të vlerës mbi 800.000 lekë, nga DRTK Shkodër për shkak të fondit të vogël. Më përpara kemi ndjekur praktikën e tenderimit të projekteve me vlerë të vogël.

Me zbatimin e procedurës së konkurimit publik të VKM nr. 425/2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar, akti nënligjor nuk shprehet për limite vlerash, duke e lënë të hapur mundësinë e zbatimit të projekteve edhe mbi vlerën 800.000 lekë, por gjithmonë në referim të buxhetit të institucionit në dispozicion dhe të shpërndarjes së tij.

Ligjërish projektet e miratuara të vitit 2018 për këtë objekt janë ende në fuqi, por teknikisht objekti ka patur nevojë për rishikim, siç është verifikuar dhe hartuar projekti në Maj të vitit 2022.

Problematika ligjore konsiston në akt-marrëveshjen e bashkëpronarëve për vazhdimin e procedurës së dërgimit për miratim të projektit në KKTKM dhe pas miratimit vijohet me zbatimin e tij, në referim të buxhetit të institucionit.

Sikurse jeni në dijeni, z. Ll i është kërkuar në rrugë zyrtare të na depozitojë dëshmitë e trashëgimisë, pasi në certifikatën e tij të pronësisë figurojnë persona që kanë ndërruar jetë. Më pas, DTRK do të ndërmjetësojë me MK, që mbi bazën e këtij dokumenti të nëshkruhet akt-marrëveshja noteriale mes bashkëpronarëve në mbështetje të ligjit të bashkëpronësisë, që të vijohet me procedurën e konkurimit publik”.

- Në vijim të seancës dëgjimore, nëpërmjet shkresës me nr. 2678 prott., datë 23.05.2023, Ministria e Kulturës ka depozituar parashtrimet si më poshtë citohen:

“Nga korrespondenca midis ASHK Shkodër dhe DRTK Shkodër, në dokumentin e azhurnuar të pronësisë për banesën e “Xhevdet Lluja”, monument kulture i kategorisë së I-rë, rezulton se pronarët kanë një certifikatë bashkëpronësie, në të cilën figurojnë pronarë që kanë ndërruar jetë.

DRTK Shkodër ka informuar z. Ll se pas marrjes së dakordësisë nga bashkëpronarët, nuk ka asnjë pengesë për lidhjen e një akt-marrëveshjeje me DRTK Shkodër për të ndërhyrë në banesën e tij.

Përsa i përket ankimeve të paraqitura nga F. Ll për degradimin e banesës, DRTK Shkodër ka bërë me dije MK se raporti teknik i hartuar nga specialistët e saj, i është përcjellë elektronikisht Zyrës së KMD-së.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se, DRTK Shkodër ka informuar dhe do të vijojë të informojë z. Ll në lidhje me hapat proceduralë, që do të ndërmerren në kuadër të zgjidhjes së kësaj situatë deri në miratimin e projektit të restaurimit të pasurisë nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, pas aplikimit të projektit me dëshminë e trashëgimisë të freskuar, shoqëruar me relacionin shpjegues nga specialistët e DRTK Shkodër, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të subjektit ankues.

Komisioneri ka shqyrtuar çështjen bazuar në situatën e konstatuar, provat dhe informacionin e administruar gjatë procedurës administrative të zhvilluar, si dhe në analizë të legjislacionit specifik.

Bazuar në parashtrimet, kronologjinë e ngjarjeve dhe dokumentacionin e depozituar nga palët në këtë proces, Komisioneri vëren se:

Subjekti ankues, është posedues i një banese të shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë, me Urdhëresë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në vitin 1977, që është “Banesa e Hamid Llujs”. Banesa nuk rezulton të jetë regjistruar në emër të tij si person, sipas përcaktimeve ligjore lidhur me regjistrimin apo fitimin e pasurisë të paluajtshme, por rezulton (fakt i pranuar nga të gjitha palët në këtë proces administrativ) se ai është posedues i saj.

Banesa e subjektit ankues është nën një kulm me “Banesën e Xhevdet Llujs”, shpallur edhe ajo monument kulture i kategorisë së I-rë, me Urdhëresë të Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në vitin 1977.

Pra, të dyja këto banesa, të cilat gëzojnë status të veçantë, ndodhen nën të njëjtin kulm dhe janë pjesë përbërëse e të njëjtës banesë të madhe, ashtëquajtur “Banesa e Familjes Lluja”, që bazuar në aktet e depozituara rezulton se është një ndër banesat më të vjetra⁸ që ruhen deri sot në qytetin e Shkodrës, e shpallur monument kulture për nga vjetërsia rreth 280-300 vjeçare dhe shumë elementë të tjerë të vlerësuar nga instancat përkatëse.

Në pretendimet dhe kërkesat e herë pas herëshme të ankuesit, dërguar DRTK Shkodër, vërehet shqetësimi i ngritur prej tij si dhe këmbëngulja për të kërkuar nga ky institucion një ndërhyrje sa më të shpejtë e efektive, në banesën e ndodhur nën një kulm me banesën e tij “Banesa Xhevdet Lluja”, pasi për shkak të statusit të veçantë që këto dy banesa gëzojnë,

⁸ Shkresë e Muzeut Historik Shkodër, depozituar në dosje.

ndërhyrja duhet të jetë e miratuar nga vetë shteti. Gjendja e kësaj banese të pa banuar aktualisht, pranuar nga të gjitha palët në proces, është e degraduar deri në pikën sa mund të rrezikojë edhe banesën e poseduesit, ankuesit F. Ll, banesë kjo e ndodhur nën një kulm me të.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se F. Ll legjitimohet për paraqitjen e ankesës së tij pranë KMD-së si subjekt i interesuar, edhe pse pretendimi për mosndërhyrje ngrihet për “Banesën Xhevdet Lluja”, pasi ai provon se një mosveprim i institucioneve afekton në mënyrë të drejtëpërdrejtë interesin e tij si posedues i “Banesës Hamid Lluja”, pasi banesa e tij rrezikon shembjen për shkak të degradimit të banesës në një kulm me të.

Pretendimi i ankuesit për degradim të banesës sipërcituar dhe për pasojë edhe të banesës së tij, është i njohur nga DTRK Shkodër, pasi bazuar në kërkesën e tij⁹, ajo me Urdhrin nr. 196, datë 27.09.2022 “Për inspektimin e objektit pasuri kulturore Banesa e Hamid Llujes, Shkodër”, ka urdhëruar inspektimin e këtij objekti pasuri kulturore. (Banesa Hamid Llujes Shkodër).

Në zbatim të Urdhrit të mësipërm, përvoja rezultoi nga procesverbali i mbajtur nga specialistët e DTRK Shkodër¹⁰, ata kanë kryer inspektimin tek objekti monument kulture “Banesa Hamid Lluja”, objekt i cili është inspektuar vetëm nga jashtë, pasi sipas pretendimit të F. Ll, problemi është tek objekti ngjitur me banesën e tij, që është gjithashtu monument kulture “Banesa e Xhevdet Llujes”.

Në përmbajtjen e këtij procesverbali citohet, ndër të tjera se:

“ “Banesa Xhevdet Lluja” paraqitet në gjendje shumë të degraduar dhe në rrezikshmëri shembjeje. “Banesa Xhevdet Lluja” është në kulm të “Banesës Hamid Lluja”, duke krijuar problem për këtë të fundit përvoja i përket strukturës.

Të pasurit një kulmi dhe një paretë të përbashkët, krijojnë probleme lagështie, dhe jo vetëm, për “Banesën Hamid Lluja” “.

Fotot bashkëlidhur këtij procesverbali dokumentojnë gjendjen e degradimit të rëndë të “Banesës Xhevdet Lluja”.

Në vijim të inspektimit të mësipërm, DTRK Shkodër, nëpërmjet shkresës me nr. 287/2 prot., datë 14.10.2022 i është drejtuar IKTK me një kërkesë për bashkëpunim, në kuadër të nevojës për ndërhyrje në pasurinë kulturore “Banesa e Hamid Llujes”.

DTRK Shkodër ka kërkuar nga IKTK, ngritjen e një grupi pune të përbashkët me specialistët e të dy institucioneve, për vlerësimin e situatës për ndërhyrje si dhe hartimin e një projekti për objektin e lartpërmendur.

Subjekti ankues është informuar në vijimësi¹¹ se, si kusht paraprak për lidhjen e akt-marrëveshjes ndërmjet pronarëve aktualë të këtyre dy banesave (“Banesa Hamid Lluja” dhe

⁹ Kërkesa me nr.13/1 prot., datë 14.07.2022.

¹⁰ Specialistët e sektorit AAAMTK (S. K; F. M dhe E. L)

¹¹ Shkresat përkatëse depozituar pranë KMD-së.

“Banesa Xhevdet Lluja”) dhe DRTK Shkodër, si hap përmbyllës i aplikimit për miratim në instancat e tjera përgjegjëse, është depozitimi i dokumentacionit të kërkuar nga subjekti ankues, që është marrja e dakordësisë nga bashkëpronarët dhe dëshmia e trashëgimisë e freskuar.

Subjekti ankues është informuar se, poseduesit e këtij objekti/banese nën një kulm, duhet që së pari të zgjidhin çështjen e dokumentacionit të pronës/banesës në posedim aktualisht dhe më pas të vijojnë me procedurat e mëtejshme për ndërhyrje në banesën në një kulm e cila rrezikon edhe banesën e subjektit ankues.

Subjekti ankues nuk ka depozituar pranë KMD-së asnjë dokument apo akt që të provojë se ai ka depozituar pranë DRTK Shkodër, IKTK apo MK, dokumentacionin ligjor në formën e kërkuar nga ligji, lidhur me vërtetimin e pronësisë së “ Banesës Hamid Lluja”, e cila është klasifikuar si pasuri kulturore që mbrohet nga shteti.

Nga ana tjetër, lidhur me masat e ndërmarra nga institucionet përgjegjëse për zgjidhjen e problematikës së subjektit ankues, Komisioneri vëren se:

- Së pari ka analizuar legjislacionin përkatës, lidhur me përgjegjësitë e institucioneve përgjegjëse, lidhur me kompetencat e detyrimet për ruajtjen e mbikëqyrjen e banesave të shpallura monumente kulturore të kategorisë së parë, si pjesë e pasurisë kulturore që mbrohet me ligj nga shteti.
- **Në këtë kontekst, kuadri ligjor i zbatueshëm në këtë rast është si më poshtë citohet:**

Ligji nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, në nenin 2, të tij ka parashikuar se: “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe autoriteteve shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive e të vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, pavarësisht vendndodhjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Neni 5, në pikat: 36, shkronjat a) ka parashikuar se: “ “Monument kulturore” është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti. Në kuptim të këtij ligji, në bazë të intensitetit të ndërhyrjes në pasuritë kulturore, këto të fundit kategorizohen në:

a) “Monument kulturore i kategorisë I” është ndërtimi me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore, i cili ruhet në tërësinë e përbërësve të tij arkitektonikë dhe teknikë. Kompozimi i vëllimeve, trajtimi arkitektonik i pamjeve të jashtme e të brendshme, si dhe zgjidhja planimetrike e funksionale e këtyre monumenteve nuk mund të ndryshohen.

.....

40. “Pasuri kulturore materiale” është tërësia e pasurive të luajtshme e të paluajtshme që, sipas përcaktimeve të neneve 50 dhe 51, të këtij ligji, kanë interes artistik, historik, arkeologjik, arkitektonik, urbanistik, etnografik, arkivistik, bibliofilik, si dhe objekte të tjera, të përcaktuara ose parashikuara nga ligji si bartës të pasurive të qytetërimeve.

50. “Restaurim” është vlerësimi i thelbit origjinal të vlerave të pasurive kulturore nëpërmjet ndërhyrjeve për ndalimin e degradimeve të mëtejshme, nxjerrjen në pah të vlerave kulturore dhe transmetimin e tyre. Në rastin e vlerave të trashëgimisë kulturore të paluajtshme, që gjenden në zona të deklaruara me rrezik sizmik, sipas ligjeve në fuqi, restaurimi përfshin edhe ndërhyrjet për përmirësim strukturor.

Në nenin 7¹² parashikohet se: “Ruajtja e pasurive kulturore është procesi sistematik i kërkimit, studimit, identifikimit, dokumentimit, regjistrimit, konservimit, restaurimit dhe përshtatjes. Mbrojtja e pasurive kulturore është sistemi i masave të ndërmarra, përfshirë iniciativat ligjore, të cilat synojnë harmonizimin e praktikave të vlefshme për sigurimin e ruajtjes së këtyre pasurive për shfrytëzim me interes publik”.

Neni 11¹³, në pikën 1, të tij ka përcaktuar se, shteti siguron ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore, në zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 21, i këtij Ligji, ka parashikuar të drejtat e pronarëve dhe poseduesve të pasurive kulturore, duke sanksionuar se:

“Pronarët dhe poseduesit e pasurive të paluajtshme kulturore kanë të drejtë:

a) Të përfitojnë konsultime, ekspertiza dhe rekomandime nga autoritetet kompetente për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave kulturore;

.....

c) Të aplikojnë për mbështetje financiare, në kuadër të programeve të financuara nëpërmjet buxheteve të qeverisjes qendrore apo vendore ose burimeve të tjera, për qëllime të kryerjes së emergjencës ose të konsolidimit, konservimit dhe restaurimit të nevojshëm për mbrojtjen e vlerës kulturore;

ç) Të marrin ndihmë financiare ose të ardhura të tjera, në formën e donacionit apo sponsorizimit nga persona dhe institucione të veçanta”.

Detyrimet e pronarëve dhe poseduesve të pasurive kulturore, janë parashikuar në nenin 22, të Ligjit, shprehimisht:

“1. Pronarët dhe poseduesit e pasurive të paluajtshme kulturore:

¹² “Ruajtja dhe mbrojtja e pasurive kulturore”

¹³ “Funksioni i institucioneve publike”

- a) Kujdesen për të ruajtur dhe mbajtur në gjendje të mirë pasuritë kulturore, duke respektuar dispozitat e këtij ligji;
- b) Informojnë institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore, inspektoratin përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për çdo dëmtim, zbulim, apo çdo veprim të parashikuar në këtë ligj;
- c) Koordinohen në zbatim të parashikimeve të këtij ligji, për hartimin, miratimin e projekteve të ndërhyrjeve dhe zbatimin e punimeve me institucionet e specializuara të trashëgimisë kulturore;
- ç) Bashkëpunojnë me institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore për ushtrimin e të drejtave të tyre dhe zbatimin me efikasitet të detyrimeve që lindin nga ky ligj;
- d) Paraqesin dokumentacionin e nevojshëm dhe vënë në dispozicion pasurinë për verifikim dhe për të siguruar mbështetjen e autoriteteve përkatëse në ushtrimin e kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj... ”.

Detyrimi i pronarit ose poseduesit të pasurisë kulturore së paluajtshme për njoftim dhe kryerjen e ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse, parashikohet në nenin 23, të Ligjit, duke sanksionuar shprehimisht se:

“1. Në rast të paraqitjes së rrethanave të rrezikut të dëmtimit të një pasurie kulturore të paluajtshme ose shkatërrimit të saj, pronari, ose poseduesi i pasurisë së paluajtshme përkatëse, në bashkëpunim me drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore dhe institucionet e tjera të specializuara, ndërmarrin hapa të menjëhershëm për të siguruar pasurinë kulturore, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Në rastin e mosveprimit nga ana e pronarit, poseduesit të pasurisë kulturore dhe kryerjes nga ana e shtetit të projektimit e zbatimit të ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, me fonde publike apo të siguruara nga partnerët e tij, bazuar në dispozitat e Kodit Civil për mjetet për garantimin e detyrimeve, për të siguruar arkëtueshmërinë e shpenzimeve të bëra, vendoset një barrë ligjore mbi pasurinë kulturore, e barabartë me vlerën e certifikuar të shpenzimit. Të drejtat e pronarit, poseduesit, sigurohen nëpërmjet zbatimit të procedurave të parashikuara në këtë ligj”.

Neni 304, i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ka parashikuar se: “Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë. Posedimi mund të ushtrohet drejtpërsëdrejti ose nga një person që mban sendin”.

Institucionet respektive, pranë të cilave subjekti ankues ka adresuar problematikën e tij, e kanë njohur dhe pranuar si posedues të pasurisë kulturore të paluajtshme “Banesës Hamid Lluja”, pavarësisht faktit se ai nuk ka provuar me dokumentat e kërkuar sipas përcaktimeve në legjislacion të qenurit pronar i kësaj prone.

Kodi Civil, i ndryshuar, në nenet 192 e 193, të tij ka parashikuar se:

“Neni 192

Sendet e paluajtshme dhe faktet që kanë lidhje me gjendjen juridike të tyre regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Regjistrimi bëhet në bazë të një akti publik, të një vendimi gjykate apo të një organi tjetër shtetëror kompetent, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 193

Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme:

- a) kontratat për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe aktet për pjesëtimin vullnetar të tyre;*
- b) kontratat me të cilat krijohen, njihen, ndryshohen ose pushojnë të drejta pronësie mbi sendet e paluajtshme, të drejta uzufukti, përdorimi e bujtjeje, emfiteoze e servituti e të drejta të tjera reale;*
- c) aktet me të cilat hiqet dorë nga të drejta pasurore të mësipërme;*
- ç) vendimet e gjykatave me të cilat njihet cilësia e trashëgimitarit dhe fitohet pasuria e trashëguar;*
- d) aktet me të cilat krijohet një shoqëri ose një subjekt tjetër i së drejtës që ka në pronësi pasuri të paluajtshme ose gëzon të drejta të tjera reale mbi to;*
- dh) vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, pjesëtimin e pasurive të paluajtshme ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë rregullisht, si dhe aktet e përmbarimit gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme ose shitjen në ankand të tyre”.*

Bazuar në nenin 29¹⁴ dhe 30¹⁵, të ligjit nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”,

- Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore/IKTK, është institucion kombëtar i specializuar shkencor, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

- IKTK-ja ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale, me qëllim gjurmimin, hulumtimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale.

- IKTK-ja, në përmbushje të funksioneve të veta, monitoron dhe bashkërendon punën me drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore, bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet publike dhe private, vendase apo të huaja, në fushën e trashëgimisë kulturore materiale.

IKTK -ja, ndër të tjera ka edhe këto kompetenca:

¹⁴ “Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore”

¹⁵ “Kompetencat e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”

- Harton projekte konservimi, restaurimi, vlerësimi, terma reference, projekte të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe bashkërendon punën për zbatimin e tyre në nivel kombëtar e vendor.

- Harton plane menaxhimi në bashkëpunim me institucione të vetëqeverisjes vendore, partnerë publikë e privatë, vendas dhe të huaj.

Neni 31 parashikon përgjegjësitë dhe kompetencat e drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore, specifikisht si më poshtë citohet:

- Drejtoritë rajonale të trashëgimisë kulturore/DRTK-të, janë institucione rajonale të specializuara, tekniko-administrative, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

- DRTK-të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim gjurmimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore, në territorin që ato administrojnë.

- DRTK-të, për të kryer funksionet e tyre, monitorohen dhe koordinohen nga IKTK-ja, si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e DRTK-ve. Ato bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën me institucionet e vetëqeverisjes vendore, personat fizikë ose juridikë, publikë dhe privatë, shqiptarë apo të huaj në fushën e trashëgimisë kulturore.

- DRTK-të kanë këto kompetenca:

a) Zbatojnë konventat ndërkombëtare të ratifikuara në Republikën e Shqipërisë në fushën e trashëgimisë kulturore materiale;

b) Gjurmojnë dhe përgatisin vlerësime paraprake e gjithëpërfshirëse për deklarimin e interesit kulturor dhe dhënien e statusit të mbrojtjes;

c) Kryejnë verifikime sistematike për gjendjen e pasurive kulturore në territorin që administrojnë, si dhe në bazë të kërkesave të paraqitura;

ç) Kryejnë verifikime dhe marrin masa, sipas përcaktimeve të këtij ligji, në raste të situatave emergjente, kur rrezikohet gjendja e pasurive kulturore;

d) Hartojnë projekte konservimi, restaurimi, vlerësimi, projekte të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore dhe bashkërendojnë punën për zbatimin e tyre në nivel rajonal e vendor;

dh) Kryejnë punime konservimi dhe restaurimi në pasuritë kulturore në bazë të projekteve të miratuara;

e) Kryejnë mbikëqyrjen dhe kolaudimin e zbatimit të punimeve në pasuritë kulturore materiale;

ë) Kryejnë çdo funksion tjetër të parashikuar me ligj.

Mbrojtja e ruajtja e pasurive kulturore është parashikuar respektivisht në nenet e mëposhtme:

Neni 71¹⁶, i Ligjit parashikon se:

- Institucionet e specializuara, sipas fushës së tyre të kompetencës, të parashikuar në këtë ligj ose në akte nënligjore në zbatim të tij, kanë të drejtë të kontrollojnë gjendjen teknike dhe kushtet e ruajtjes së pasurive kulturore, si dhe të zonave që u nënshtrohen dispozitave të mbrojtjes indirekte.
- Institucionet e specializuara, të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, ushtrojnë kontrollin teknik mbi kushtet e ruajtjes së pasurive kulturore të paluajtshme për pasuritë në pronësi, posedim ose administrim të subjekteve private, institucioneve të vetëqeverisjes vendore dhe subjekteve juridike të tjera publike vendore dhe të bashkësive fetare të regjistruara.
- Pronarët, poseduesit, bashkësitë fetare të regjistruara dhe të gjitha subjektet e tjera administruese të pasurisë kulturore të paluajtshme janë të detyruar të lejojnë kontrollin e gjendjes fizike e të kushteve të ruajtjes së pasurisë nga institucionet e specializuara, sipas pikës 1 të këtij neni.
- Institucioni i specializuar që fillon procedurën e kontrollit teknik njofton drejtpërdrejt pronarin, poseduesin, subjektin administrues, nëpërmjet një njoftimi me shkrim, 5 ditë përpara kryerjes së kontrollit.
- Gjatë kontrollit mbahet një procesverbal, i cili përmban identitetin e pronarit, të poseduesit ose subjektit administrues, datën, vendin dhe orën e kryerjes së kontrollit, një përshkrim fizik të pasurisë /pasurive objekt kontrolli, si dhe një analizë të gjendjes fizike e teknike të pasurisë.
- Një kopje e procesverbalit i njoftohet pronarit, poseduesit ose subjektit administrues brenda 5 ditëve nga përfundimi i kontrollit. Pronari, poseduesi, ose subjekti administrues kanë të drejtë të paraqesin vërejtjet e tyre brenda 10 ditëve, nga njoftimi i procesverbalit. Nëse këto subjekte nuk shprehen brenda afatit të parashikuar në këtë pikë, do të konsiderohet se kanë pranuar konkluzionet e grupit të kontrollit.
- Pas njoftimit të observacioneve ose përfundimit të afatit të parashikuar në pikën 6, të këtij neni, një kopje e procesverbalit dhe vërejtjeve të paraqitura nga pronari, poseduesi ose subjekti administrues i përcillet titullarit të institucionit të specializuar, i cili miraton raportin përfundimtar për kryerjen e kontrollit.
- Nëse në fund të procesit të kontrollit titullari i institucionit të specializuar në raportin përfundimtar konstaton dëmtime, cenime, përdorim të pasurisë kulturore në kundërshtim me karakterin e tyre historik ose artistik apo që vënë në rrezik ruajtjen e tyre, ose ndërhyrje të paautorizuara, njofton inspektoratin shtetëror që mbulon fushën e trashëgimisë kulturore.

¹⁶ “Kontrolli teknik”

- Nëse në fund të procesit të kontrollit titullari i institucionit të specializuar, kur është i ndryshëm nga DRTK-ja, në raportin përfundimtar konstaton nevojën për ndërhyrje të nevojshme ruajtëse, njofton DRTK-në kompetente.

- Në rastin kur pronari, poseduesi, bashkësitë fetare të regjistruara dhe të gjitha subjektet administruese të pasurisë kulturore të paluajtshme veprojnë në kundërshtim me detyrimin e parashikuar në pikën 3, të këtij neni, grupi i kontrollit informon drejtpërdrejt inspektoratin shtetëror që mbulon fushën e trashëgimisë kulturore, i cili merr masa në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

VKM nr. 531, datë 28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, ka përcaktuar mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të veprimtarisë së DTRK, si dhe përgjegjësitë funksionale të tyre, duke parashikuar specifikisht se:

- DTRK-të janë institucione rajonale të specializuara, tekniko-administrative buxhetore, në varësi të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, me seli në Tiranë, Shkodër, Vlorë, Korçë, Berat e Gjirokastrë. DTRK-të, të cilat për të kryer funksionet e tyre, monitorohen dhe koordinohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore/IKTK.
- DTRK-të kanë për mision gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore për çdo territor që secila prej tyre administron.
- DTRK-të kanë përgjegjësi të organizojnë punën për realizimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive në fushën e trashëgimisë kulturore materiale lidhur me gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore në territorin që administrojnë.

Pika 10, e kësaj VKM-je përcakton se DRTK-të, në territorin përkatës që mbulojnë, kryejnë detyrat, ndër të tjera, si më poshtë vijon:

- a) Kryejnë verifikime sistematike apo në bazë të kërkesave të paraqitura për gjendjen e pasurive kulturore në territorin që administrojnë, si dhe ushtrojnë kontrollin teknik për kushtet e ruajtjes së pasurive kulturore...
 - b) *Kryejnë ndërhyrje, punime konservimi dhe restaurimi në pasuritë kulturore në bazë të projekteve të miratuara në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale.*
- Së dyti ka analizuar përgjegjësitë e institucioneve përkatëse, lidhur me kompetencat e detyrimet për ruajtjen e mbikëqyrjen e banesave të shpallura monumente kulture të kategorisë së parë, si pjesë e pasurisë kulturore që mbrohet me ligj nga shteti.

➤ **Veprimet e ndërmarra nga DRTK Shkodër, lidhur me sa më sipër:**

DRTK Shkodër, në zbatim të kompetencave të parashikuara në ligjin 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, kanë ndërmarrë veprimet përkatëse në përmbushje të sa më sipër.

Kështu, bazuar në aktet e depozituara pranë KMD-së, rezulton se DRTK Shkodër, mbi bazën e informacionit të paraqitur në ankesën e subjektit ankues (sipërcituar në vendim) ka realizuar inspektimin lidhur me shqetësimin e ngritur nga z. Ll për degradimin e banesës në një kulm me banesën e tij “Banesës Xhevdet Lluja”, e cila rrezikon të shembet por edhe të rrezikojë qëndrueshmërinë e kushtet e banesë së tij, “Banesa Hamid Lluja”, që të dyja të mbrojtura nga shteti, pasi gëzojnë statusin e pasurisë kulturore, monumente kulture të kategorisë së I-rë.

Bazuar në konstatimet e këtij inspektimi, DRTK Shkodër ka hartuar Raportin Teknik (me nr. 139/1 prot., datë 28.03.2023), të cilin, bashkë me dokumenta të tjerë provues, ia ka dërguar IKTK.

DRTK Shkodër ka informuar IKTK lidhur me emergjencën për ndërhyrje që paraqet banesa “Xhevdet Lluja”, duke cituar se:

“Banesa e “Hamid Llujes” rrezikon shembje pjesore nga banesa ngjitur “Banesa Xhevdet Lluja”, pasi kanë të njëjtin kulm dhe lënda drusore është e njëjtë dhe në gjendje të kalbur.

Gjendja e “Banesës Xhevdet Lluja” paraqitet tejet alarmante. Objekti rrezikon shembjen si shkak i infiltrimit të shirave nga çatia dhe mungesës së mirëmbajtjes. Në fasadën kryesore janë të vendosura skeleri të cilat mbajnë strehën e çatisë. Ndërkati i banesës nuk është statikisht i qëndrueshëm, pasi lënda drusore është e kalbur. Shkalla që të çon për në katin e dytë është gjithashtu e degraduar. Çarje vërehen edhe në muraturë. Banesa ka nevojë emergjente për ndërhyrje restauruese dhe rikonstruksion të strukturës mbajtëse, pasi mund të bëhet problem edhe për banesën ngjitur me të, atë të “Hamid Llujes”.

DRTK Shkodër, bazuar në nevojën emergjente për ndërhyrje, ka hartuar projektin e plotë “Restaurim dhe konservim i plotë banesa “Xhevdet Lluja Shkodër”, me vlerë preventivi 5.375.684 lekë, i cili i është përcjellë IKTK-së¹⁷.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, hapat e ndërmarra nga DRTK Shkodër, janë në përputhje dhe në zbatim të parashikimeve specifike ligjore të kompetencave të saj, kështu:

- DRTK-ja përgatit një relacion teknik dhe deklaron nevojën e ndërhyrjes, sipas nenit 90, të këtij ligji, veprim që është ndërmarrë prej saj në rastin konkret.
- DRTK-ja dërgon në KKTKM një projekt dhe preventivin përkatës në afatin e caktuar nga DRTK-ja, vetë DRTK-ja merr masa për hartimin e projektit dhe njofton menjëherë Inspektoratin Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore, veprim edhe ky i përmbushur prej saj.

¹⁷ Përcjellë elektronikisht me e-mail pranë IKTK -së në maj 2022.

- Projekti, preventivi total dhe preventivi mbi shpenzimet për mbrojtjen e vlerës kulturore të pasurisë kulturore paraqiten për miratim nga KKTKM-ja dhe duhet të përmbajnë specifikimet e nevojshme, si dhe afatin për fillimin e punimeve, veprim ky i cili nuk rezulton të jetë përmbushur prej saj, pasi është i kushtëzuar nga përmbushja e detyrimit të *poseduesit* të banesës, pasuri kulturore, për të depozituar aktet provuese të statusit juridik të pasurisë.

Aplikimi për miratim të projektit të ndërhyrjes në KKTKM bëhet përmes portalit e-Albania dhe për procedimin e saj kërkohet statusi juridik i pasurisë. Meqenëse pasuria kulturore në fjalë është banesë me pronësi private, pas shqyrtimit të statusit juridik të saj, lidhet akt-marrëveshja ndërmjet pronarëve aktualë (poseduesve aktualë) dhe DRTK Shkodër dhe në vijim të kësaj aplikimi dërgohet për miratim në KKTKM.

KKTKM pas shqyrtimit të akteve sa më sipër, merr vendimin, si organi kompetent për miratimin ose jo të projektit të dërguar për miratim nga DRTK Shkodër.

Subjekti ankues nuk ka depozituar pranë KMD-së asnjë dokument apo akt që të provojë se ai ka depozituar pranë DRTK Shkodër, dokumentacionin ligjor në formën e kërkuar nga ligji, lidhur me vërtetimin e pronësisë së “Banesës Hamid Lluja”.

DRTK-të, për të kryer funksionet e tyre, monitorohen dhe koordinohen nga IKTK-ja, si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e DRTK-ve. Ato bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën me institucionet e vetëqeverisjes vendore, personat fizikë ose juridikë, publikë dhe privatë, shqiptarë apo të huaj në fushën e trashëgimisë kulturore. Në këtë këndvështrim, DRTK Shkodër ka informuar IKTK për gjendjen alarmante të “Banesës Hamid Lluja” dhe për nevojën e ndërhyrjes emergjente të saj, duke e dokumentuar edhe me aktet provuese.

Përsa i takon veprimeve të ndërmarra nga DRTK Shkodër, Komisioneri vlerëson se, ato janë ndërmarrë në përputhje dhe në zbatim të kompetencave e detyrave të saj, sipas parashikimit në ligjin 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, dhe se nuk rezulton të kenë trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme subjektin ankues, lidhur me shqyrtimin, vlerësimin e hapat e ndërmarrë prej saj, në kuadër të evidentimit të nevojës për ndërhyrje emergjente në banesën “Xhevdet Lluja”, gjë e cila afekton drejtëpërdrejtë në kushtet e gjendjen e banesës së vetë subjektit ankues.

Në mungesë të këtij trajtimimi, bie poshtë edhe pretendimi për diskriminim, i cili në thelb do të duhet të kishte pikërisht konstatimin e trajtimit të pabarabartë apo të pafavorshëm, të lidhur domosdoshmërisht me “shkakun/shkaqet” e pretenduar/a.

Rrjedhimisht, Komisioneri gjykon se nuk kemi shkelje të dispozitave ligjore të LMD-së, nga ana e DRTK Shkodër, kundrejt subjektit ankues, ardhur për shkaqet e pretenduara prej tij.

➤ **Veprimet e ndërmarra nga IKTK dhe MK, lidhur me sa më sipër:**

Bazuar në kompetencat e parashikuara në ligjin 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, IKTK, është njësia përgjegjëse për mbarëvajtjen e DRTK-ve, me të cilat bashkëpunon dhe bashkërendon punën në fushën e trashëgimisë kulturore.

Në këtë kontekst, lidhur me problematikën objekt shqyrtimi, IKTK është informuar nga DRTK Shkodër për gjendjen alarmante të “Banesës Hamid Lluja” dhe për nevojën e ndërhyrjes emergjente të saj, duke e dokumentuar edhe me aktet provuese.

IKTK¹⁸ ka mbajtur të njëjtin qëndrim me DRTK Shkodër, duke evidentuar problematikën e mosdorëzimit nga ana e subjektit ankues të dokumentacionit lidhur me pronësinë e banesës, i cili duhet të jetë sipas kërkesave ligjore dhe i freskuar, gjë që, në mungesë të dorëzimit të tij nga z. Ll/poseduesi i kësaj pasurie, është bërë pengesë për vijimin e procedurës për aplikimin e miratimit të projektit për ndërhyrje në banesën në fjalë monument kulture, pranë organit kompetent që është KKTKM, pranë Ministrisë së Kulturës.

Ministria e Kulturës ka qenë në dijeni të kësaj problematike të banesës në fjalë, pasi është informuar në vijimësi lidhur me nevojën e ndërhyrjes emergjente për shkak të rrezikut evident për shembjen e saj, dhe po ashtu rrezikut potencial për shembje të pjesshme edhe të banesës “Hamid Lluja”, banesa këto të dyja të shpallura monumente kulture të kategorisë së I-rë, pasuri kulturore të mbrojtura nga shteti.

Ligji nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, përcakton se objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe autoriteteve shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, administrimin e pasurive e të vlerave të trashëgimisë kulturore, trashëgimisë kulturore muzeore, si dhe vlerave kombëtare të peizazhit, pavarësisht vendndodhjes së tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sipas përcaktimeve të këtij Ligji, shteti siguron ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin dhe administrimin e trashëgimisë kulturore, në zbatim të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi¹⁹, si dhe ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore (Ministria e Kulturës, në këtë rast) ushtron funksionet e ruajtjes, mbrojtjes, vlerësimit dhe administrimit të pasurive kulturore në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi²⁰.

Neni 38, i Ligjit ka parashikuar se: “*Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale është organ kolegjal vendimmarrës pranë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore, i*

¹⁸ Procedura për aplikimin është e publikuar në e-Albania:

https://e.albania.al/eAlbaniaServices/ServiceList.aspx?service_filter=INS&institution_id=708&service_type=Y

¹⁹ Neni 11, i Ligjit.

²⁰ Neni 12, i Ligjit.

cili kryesohet nga ministri dhe përbëhet nga 15 anëtarë, të përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. KKTKM-ja ka kompetencë:

.....

b) të miratojë projektet e mirëmbajtjes, të ruajtjes dhe restaurimit të pasurive kulturore materiale, të hartuara nga institucionet e trashëgimisë kulturore që mbulojnë veprimtarinë përkatëse, si dhe subjektet e licencuara për këtë qëllim;

....

ç) të miratojë lejet për ndërhyrjet me karakter ruajtës e mbrojtës të pasurive kulturore të paluajtshme, sipas parashikimeve të këtij ligji, si dhe lejet e parashikuara në këtë ligj.

3. b) Këshilli i Trashëgimisë Kulturore Materiale, i përbërë nga 15 anëtarë, vepron si organ vendimmarrës në lidhje me kërkesat për ndërhyrje mbi pasuritë kulturore të luajtshme e të paluajtshme; pasuritë arkeologjike dhe çdo kërkesë të lidhur të fushës, sipas parashikimeve të këtij ligji”.

Në nenin 77²¹ parashihet se:

- Çdo ndërhyrje në pasuritë kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme kryhet vetëm pas miratimit nga ana e KKTKM-së ose ministrit, sipas rastit të ndërhyrjes në pikën 3, të këtij neni, referuar intensitetit të ndërhyrjeve të parashikuara në kartelën e pasurisë.

- Kryhen:

a) Vetëm me leje të KKTKM-së: ndërhyrjet e çdo lloji, të cilat nuk ndalohen taksativisht me këtë ligj;

b) Vetëm me leje të KKTKM-së: shkëputjet, qofshin edhe të pjesshme, të pasurive kulturore materiale;

c) Me leje të KKTKM-së dhe të njësisë së vetëqeverisjes vendore: ndërhyrjet në lidhje me rindërtimin e pasurive kulturore materiale;

ç) Vetëm me leje të KKTKM-së: gërmimi, restaurimi, përdorimi dhe çdo veprim tjetër në pasuritë kulturore, si dhe çdo ndërhyrje në truallin e vënë në mbrojtje rreth tyre;

.....

- Kryerja e ndërhyrjeve në kundërshtim me këtë nen përbën shkelje dhe subjekti përgjegjës mban përgjegjësi në përputhje me këtë ligj. Përveç sanksioneve të parashikuara në këtë ligj, organi kompetent vendos edhe detyrimin për rivendosjen në vend të situatës dhe kthimin në gjendjen e mëparshme, me shpenzimet e personit që ka kryer ndërhyrjen e paligjshme.

- Punimet për rivendosjen në vend të situatës dhe kthimin në gjendjen e mëparshme kryhen nën mbikëqyrjen e DRTK-së.

²¹ “Ndërhyrjet e lejuara”

Neni 78 “Ndërhyrjet në rastet e urgjencës”

1. Pronari ose poseduesi i pasurisë kulturore, në raste të jashtëzakonshme, kur rrezikohet dëmtimi i pasurive kulturore, mund të marrë masa urgjente me karakter të përkohshëm ose me karakter parandalues të rrezikut të dëmtimit të pasurisë kulturore. Në këtë rast, pronari ose poseduesi njofton menjëherë DRTKnë dhe brenda 48 orëve vë në dispozicion projektin dhe preventivin ose kërkesën për ndërhyrjen përfundimtare, me qëllim marrjen e lejeve të nevojshme.

2. Kërkesa, projekti dhe preventivi i punimeve, i depozituar sipas pikës 1, të këtij neni, shqyrtohet nga KKTKM-ja, në kushtet e pikës 2, të nenit 77, ose ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, në kushtet e pikës 3, të nenit 77, të këtij ligji, me procedurë të përshpejtuar.

3. Për ndërhyrjet e miratuara me procedurë të përshpejtuar KKTKM-ja shprehet me vendim brenda 15 ditëve, për ndërhyrjet e parashikuara në pikën 2, të nenit 77, dhe ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore brenda 10 ditëve, për miratimin e ndërhyrjeve sipas pikës 3, të nenit 77, të këtij ligji.

5. Në rastin e mosveprimit të pronarit ose poseduesit, me qëllim shmangien e dëmtimeve në pasurinë kulturore ose në rastet e kryerjes nga ana e tij të ndërhyrjeve të paligjshme, sipas pikës 4, të këtij neni, DRTK-ja ose institucioni apo subjekti i autorizuar nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore ndërhyjnë për mirëmbajtjen e pasurisë. Shpenzimet, në këtë rast, mbulojnë nga pronari ose poseduesi.

6. Mosveprimi ose mosnjoftimi, sipas detyrimeve të këtij neni, përbën shkelje dhe pronari ose poseduesi mbajnë përgjegjësi sipas këtij ligji.

Neni 79 “Leja për ndërhyrjet në pasuritë kulturore”

- Leja për ndërhyrje është e nevojshme për çdo ndërhyrje të parashikuar nga neni 77 i këtij ligji.

- Dokumenti i lejes për ndërhyrje përshkruan të gjitha kushtet për kryerjen e punimeve në pasuritë kulturore, në përputhje me dokumentacionin shoqëruar të kërkesës, projektit e preventivit, si dhe të normave e standardeve të përcaktuara në këtë ligj.

- Leja firmoset nga kryetari i KKTKM-së dhe i jepet subjektit kërkuar pas kryerjes së pagesës së tarifës së lejes për ndërhyrje në pasuritë kulturore.

- Përfituesi i lejes për ndërhyrje, pronari i pasurisë kulturore, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve janë përgjegjës solidarë, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe dispozitave ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë.

- Lejet për ndërhyrje, të miratuara në kundërshtim me ligjin dhe/ose me dokumentet e planifikimit në fuqi, janë të pavlefshme.

- Leja e parashikuar në nenin 77, të këtij ligji, jepet për projektin e paraqitur nga kërkuesi ose, në rastet e mungesës së projektit, kur kërkesa për leje vlerësohet e mjaftueshme dhe përmban kushtet specifike, në funksion të qëllimit të ndërhyrjes.

- Afati për fillimin e punimeve nuk mund të jetë më shumë se 1 vit, nga data e miratimit të lejes për ndërhyrje. Afati i përfundimit të punimeve përcaktohet në bazë të kalendarit të punimeve të miratuar nga KKTKM-ja. Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve dhe ndryshimi i subjektit zbatues të përcaktuar në lejen e ndërhyrjes kryhen nga autoriteti që ka miratuar lejen, me kërkesë të subjektit të pajisur me licencë. Shtyrja e afatit të përfundimit të punimeve bëhet vetëm një herë, për një periudhë jo më të gjatë se afati fillestar i përcaktuar në lejen e ndërhyrjes, mbi bazën e një kërkesë të dorëzuar brenda afatit të vlefshmërisë së lejes dhe, në çdo rast, jo më vonë se 45 ditë përpara përfundimit të afatit të lejes. Kërkesa për shtyrjen e afatit parashtron arsyet për të cilat nuk ka qenë i mundur përfundimi i punimeve brenda afatit dhe shoqërohet nga kalendar i ri i punimeve. Kërkesa për shtyrjen e afatit të punimeve konsiderohet e miratuar në heshtje nëse autoriteti, që ka lëshuar lejen, nuk i njofton vendimin përkatës subjektit kërkues brenda afatit 45-ditor nga dita e depozitimit të kërkesës.

- Për përfundimin e punimeve të papërfunduara brenda afatit të përcaktuar është e detyrueshme pajisja me një leje të re ndërhyrjeje.

- Subjekti, i cili ka kryer ndërhyrje të paligjshme ose ka punime të filluara prej më shumë se tre vjetësh dhe ende të papërfunduara, sipas projektit të miratuar, mban përgjegjësi në përputhje me këtë ligj. Përveç sanksioneve të parashikuara në këtë ligj, organi kompetent për lëshimin e lejes së ndërhyrjes vendos edhe detyrimin për rivendosjen në vend të situatës apo zbatimin e plotë të ndërhyrjes me shpenzimet e personit që ka kryer ndërhyrjen e paligjshme apo është në tejkalim të afatit të lejes.

Neni 80 “Procedura e lejes për ndërhyrje”

1. Kërkesa për lëshimin e lejes, e parashikuar në nenin 77, të këtij ligji, paraqitet në sportelin unik të KKTKM-së pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore. Format i kërkesës dhe dokumentacioni shoqëruet përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

2. Në varësi të kategorisë së pasurisë për të cilën kërkohet të kryhet ndërhyrja ose në varësi të llojit të ndërhyrjes, kërkesa e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, i dërgohet, përkatësisht, IKTK-së, brenda 5 ditëve nga dorëzimi i kërkesës, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. KKTKM-ja shprehet me vendim brenda afatit 45-ditor nga paraqitja e kërkesës, në bazë të relacionit teknik të IKTK-së.

Neni 90 “Ndërhyrjet e detyruara ruajtëse”

1. Subjektet private, që kanë në pronësi ose në posedim pasuri kulturore, detyrohen të marrin masat për kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme që garantojnë ruajtjen e pasurive që kanë në pronësi ose posedim. Domosdoshmëria e ndërhyrjeve vërtetohet nga DRTK-ja, nëpërmjet përgatitjes së një relacioni teknik.

2. Në rastin e mospërbushjes së detyrimit të kryerjes së ndërhyrjeve ruajtëse nga subjektet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore merr përsipër t'i kryejë vetë këto ndërhyrje.

3. Në rastet e kryerjes së investimeve me fonde publike, procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje apo kolaudim në pasuritë kulturore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Në rastet e nevojës për kryerjen e investimeve me fonde publike, sipas pikës 3, të këtij neni, institucionet e tjera shtetërore janë të detyruara të marrin autorizimin nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

5. Marrëdhëniet e ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore me pronarin ose poseduesin e pasurisë kulturore rregullohen në përputhje me këtë ligj.

Në nenin 92, të Ligjit, parashikohet procedura e miratimit dhe zbatimit të ndërhyrjeve të detyruara ruajtëse, duke specifikuar si më poshtë:

- DRTK-ja përgatit një relacion teknik dhe deklaron nevojën e ndërhyrjes, sipas nenit 90 të këtij ligji.

- Relacioni teknik i dërgohet, së bashku me njoftimin e fillimit të procedurës, pronarit ose poseduesit të pasurisë kulturore, të cilët kanë të drejtë të shprehin vërejtjet e tyre brenda 30 ditëve, nga marrja dijani për aktet.

- DRTK-ja i cakton pronarit ose poseduesit të pasurisë kulturore një afat për paraqitjen e projektit të ndërhyrjeve të nevojshme, në përputhje me relacionin teknik. Në rast se pronari nuk dërgon në KKTKM një projekt dhe preventivin përkatës në afatin e caktuar nga DRTK-ja, vetë DRTK-ja merr masa për hartimin e projektit dhe njofton menjëherë Inspektoratin Kombëtar për Trashëgiminë Kulturore.

- Projekti, preventivi total dhe preventivi mbi shpenzimet për mbrojtjen e vlerës kulturore të pasurisë kulturore paraqiten për miratim nga KKTKM-ja dhe duhet të përmbajnë specifikimet e nevojshme, si dhe afatin për fillimin e punimeve.

- KKTKM-ja shprehet mbi projektin dhe preventivin me vendim, brenda 45 ditëve nga marrja e kërkesës.

- Vendimi i KKTKM-së i njoftohet pronarit, duke përcaktuar afatin për zbatimin e punimeve sipas vendimit të KKTKM-së.

- Ndaj vendimit të KKTKM-së mund të ushtrohet ankimi pranë organeve gjyqësore kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit të KKTKMsë.

- Nëse pronari ose poseduesi i pasurisë kulturore nuk përmbush detyrimin e depozitimit të projektit ose nuk zbaton vendimin e KKTKM-së brenda afatit të caktuar, ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore, pas komunikimit nga inspektorati/DRTK-ja për mosfillimin e punimeve nga ana e pronarit/poseduesit, ndërhyr duke filluar procedurat e përzgjedhjes së subjektit publik ose privat që do të kryejë punimet, sipas parashikimeve të këtij ligji.

- Mënyrat e ndërhyrjes nga ministria caktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

Bazuar dhe në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, duke iu kthyer rastit të subjektit ankues (dhe pavarësisht faktit nëse ai ka paraqitur apo jo dokumentacionin për provimin e pronësisë mbi banesën, sipas formës së kërkuar nga ligji), ligji ka paraprirë dhe parashikuar edhe rastet kur pronari apo poseduesi i pasurisë së shpallur monument kulture, refuzon, nuk pranon ndërhyrjen në banesën e tij.

Komisioneri shprehet se, legjislacioni ka parashikuar se, në raste të tilla (aq më tepër në këtë rast që ankuesi insiston që të merren masa për ndërhyrje në banesën objekt ankese dhe ia ka bërë të ditur organeve kompetente këtë fakt) është shteti që duhet të ndërhyjë edhe *kryesisht* me iniciativën e tij, kur vlerëson se banesa është në kushtet e nevojës emergjente për ndërhyrje, bazuar në pikën 2, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2028 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

Komisioneri thekson faktin se, vetë Ligji është kujdesur të përcaktojë të dyja këto kategori subjektsh: si *pronarët* ashtu dhe *poseduesit* e banesave, duke njohur e konsideruar edhe problematikat ligjore e faktike në lidhje me çështjet e pronësisë së kësaj kategorie banesash, (një pjesë e madhe e tyre disa qindra vjeçare). Ligji njeh kësaj si subjekt të tij, edhe *poseduesin* e banesës, në kuadër të të drejtave e detyrimeve pronësore mbi të.

Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, ministria përgjegjëse, MK, në këtë rast, do të duhej që nëpërmjet akteve nënligjore të saj, të kishte parashikuar e rregulluar edhe rastet kur banesa monument kulture nuk ka *pronar formal*, por gjithsesi ka një *posedues*, dhe më tej kryerjen e procedurave vijuese.

Insitucionet respektive, pranë të cilave subjekti ankues ka adresuar problematikën e tij, e kanë njohur dhe pranuar si *posedues të pasurisë kulturore të paluajtshme* “Banesës Hamid Lluja”, pavarësisht faktit se ai nuk ka provuar me dokumentat e kërkuar sipas përcaktimeve në legjislacion të qenurit *pronar* i kësaj prone.

Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se pretendimi i subjektit ankues lidhur me neglizhencën dhe mosveprimin e institucioneve respektive shtetërore për të marrë masa

emergjente efektive lidhur me degradimin e monumentit të kulturës “Banesës Xhevdet Lluja” në një kulm me banesën e tij, është mëse i drejtë dhe i bazuar.

Nga këqyrja dhe analizimi i deklarimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga IKTK dhe MK, Komisioneri vëren se ato nuk kanë marrë masat e nevojshme efektive në kushtet e emergjencës të situatës degraduese (të cilën vetë e pohojnë dhe dokumentojnë si të tillë) të “Banesës Xhevdet Lluja”, e cila përveçse rrezikon të shembet vetë, rrezikon po ashtu edhe “Banesën Hamid Lluja”, (të cilën e posedon ankuesi).

Nga komunikimi me këto institucione (IKTK dhe MK), vërehet se ato vetëm kanë informuar Komisionerin lidhur me situatën alarmante të banesës në fjalë, dhe në asnjë moment edhe pse Komisioneri ofroi mundësinë për ndërmjetësim mes palëve, me qëllim për të zgjidhur këtë problematikë me mirëkuptim dhe bazuar në kompetencat e përgjegjësitë ligjore të tyre, ata nuk ndërmorën asnjë hap konkret e efektiv që të dëshmonte vullnetin për të ndërhyrë sa më parë tek ky objekt/ banesë monument kuylture i kategorisë së I-rë.

Mbështetur në sa më sipër, si dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e IKTK dhe MK (në varësi të së cilës është organi vendimmarrës KKTKM).

- Lidhur me moszbatimin e dy projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve me nr. vendimi 149, datë 21.03.2018 “Restaurimi i banesës së Xhevdet Llujes”, si dhe me nr. 271, datë 31.05.2018 “Ndërhyrje konservuese – restauruese në pikturën murale dhe objekte e drurit të banesës së Xhevdet Llujes, Shkodër”, të cilat nuk janë zbatuar, Komisioneri vëren se ato nuk i nënshtrohen shqyrtimit administrativ pranë KMD-së, pasi janë jashtë afatit kohor për shqyrtimin e tyre.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon se: “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Për më tepër, bazuar në dokumentacionin e depozituar, i cili dëshmon se kushtet aktuale të banesës janë në gjendje degradimi të atillë sa rrezikon shembjen e saj, dhe se ajo tashmë ka nevojë për ndërhyrje të tjera më të specializuara dhe më efektive, zbatimi i këtyre dy vendimeve që pavarësisht se nuk janë të shfuqizuara i bën ata të pazbatueshme, pasi referuar akt-ekspertizave të mëvonshme (gjatë vitit 2022 dhe 2023) rezulton se banesa ka nevojë për ndërhyrje emergjente dhe shumë të specializuara, përtej riparimeve apo restaurimit të konkluduar në dy vendimet e KKR, sipërcituar.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2²², të ligjit nr. 10 221, date 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

B.1 Përkatësia në një grup të veçantë

Komisioneri vlerëson se “përkatësia në një grup të veçantë” është shkak për të cilin ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje.

Në lidhje me pretendimin e ankuesit për diskriminim për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”, Komisioneri gjykon se “përkatësia në një grup të veçantë” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se e mbart atë.

Subjekti ankues bazuar në dokumentacionin e depozituar gëzon statusin e të përndjekurit politik, si dhe provon faktin se ka qenë i dënuar e dëbuar për çështje politike, nga viti 1983-1988, sipas Vendimit të Komisionit Qendror të Internim Dëbimeve me nr. 12, datë 05.11.1983.

B.2 Çdo shkak tjetër

²²“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje qe nxit diskriminim.”

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh²³. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i LMD-së është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh²⁴.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bëjnë të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar staturë të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

GJEDNJ-ja ka zhvilluar disa shkaqe në kategorinë “*statuse të tjera*”. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, personale, ose “*status*”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.²⁵ Gjykata ka theksuar se fjalës “*shkak/status tjetër*” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë.²⁶ Interpretimi i këtij nocioni “nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme”²⁷.

²³ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 ‘Për Mbrojtjen nga Diskriminimi’: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.*”

²⁴ Neni 14, i KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.*”

²⁵ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

²⁶ Shiko: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

²⁷ Shiko: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të “*statuseve të tjera*” janë: Në *Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta*, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në *gradën ushtarake* mund të binte në kundërshtim me nenin 14; në *Larkos kundër Qipros*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një *dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër*; në *Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konsideroi se të qenit i *burgosur* mund të binte në nocionin e “*statusit tjetër*” sipas nenit 14; në *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e “*statusit tjetër*”, por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se *statusi si ish oficer i KGB-së* përfshihet në nenin 14; në *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhej nga skema e liritimit të parakohshëm bazuar në *kohëzgjatjen e dënimit me burg*.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Komisioneri, gjatë shqyrtimit të çështjes e analizimit sa më sipër, vlerëson, *kryesisht se*, subjekti ankues gëzon një cilësi të identifikueshme, një lloj statusi të veçantë të mbrojtur me ligj të posaçëm (ligji nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”).

Bazuar në dokumentacionin e depozituar dhe deklaratimet e të gjitha palëve në këtë proces administrativ, rezultojnë e pranuar dhe e provuar se, *subjekti ankues gëzon statusin e poseduesit të banesës “Hamid Lluja”, shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë dhe mbrojtur nga ky Ligj*.

Bazuar pikërisht në këtë status, duke qenë se banesa të ciliën ai posedon gëzon një mbrojtje të veçantë nga shteti, për shkak të statusit të saj si monument kulture i kategorisë së I-rë, ai për çdo ndërhyrje që mund të dëshirojë apo është i detyruar të bëjë, duhet që paraprakisht të marrë miratimin e organeve shtetërore përgjegjëse dhe t’i nënshtrohet një procedure të posaçme për miratimin e tyre. Ai e ka të ndaluar ligjërisht për të ndërhyrë individualisht me iniciativë personale në banesën e tij, pikërisht për shkak të këtij statusi që ajo gëzon, gjë e cila e kushtëzon dhe kërkon automatikisht miratimin paraprak të organeve të tjera të specializuara, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës për banesat që gëzojnë statusin monument kulture i kategorisë së I-rë.

Vetë ligji nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, ka parashikuar të dyja këto kategori subjektsh: si pronarët, ashtu edhe poseduesit e këtyre banesave me status të veçantë, duke i njohur dhe pranuar tashmë *de jure e de facto*, si subjekte që i nënshtrohen të drejtave e detyrimeve specifike të tij. Bazuar në këtë Ligj, si pronarët, ashtu edhe poseduesit e kësaj kategorie banesash kanë të drejta pronësie mbi to.

Në këtë kontekst, bazuar në deklaratimet, faktet e provat e sjella nga palët, bazuar në statusin e veçantë ligjor që gëzon subjekti ankues, *si posedues* i banesës monument kulture i kategorisë së I-rë, Komisioneri i vlerëson si shkak të mbrojtur nga LMD, referuar si “çdo shkak tjetër”.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

C.1 Lidhja e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm, të subjektit ankues me “çdo shkak tjetër”²⁸.

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse subjekti ankues, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga ana e institucioneve të IKTK edhe MK, bazuar pikërisht në shkakun që posedon, atë të “çdo shkak tjetër”²⁹, të poseduesit të banesës me status të veçantë, shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar. Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 59³⁰, të saj parashikon ndër të tjera, se:
“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: ...mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe”.

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor³¹.

²⁸ Referuar nën ndarjes B/3 të Vendimit.

²⁹ Bazuar në deklaratimet, faktet e provat e sjella nga palët, bazuar në statusin e veçantë ligjor që gëzon subjekti ankues, si posedues i banesës monument kulture i kategorisë së I-rë, Komisioneri i vlerëson si shkak të mbrojtur nga LMD, referuar si “çdo shkak tjetër”.

³⁰ Kreu V “Objektivat socialë”, neni 59, pika 1/g).

³¹ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011; nr. 23, datë 08.06.2011.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njih dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Neni 14 i KEDNJ-së ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqëruese shkaqesh.

Ndërkohë Protokollit 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, shtrihet përtej të drejtave të mbrojtura shprehimisht nga KEDNJ. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar:

- “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë;*
- b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*
- c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*
- d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Në dokumentin e publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës, “Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025”, ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale kulturore, është parashikuar si njëri nga qëllimet dhe objektivat specifike të kësaj strategjie kombëtare për kulturën.

Në këtë dokument³² citohet se:

“Me synim ruajtjen dhe mbrojtjen e integruar të tërësisë së vlerave të trashëgimisë kulturore, si dëshmi e vlerave të trashëguara nga e kaluara, si shprehje e identitetit kombëtar dhe si pasuri e traditës kolektive, dokumenti strategjik përcakton paketën e projekteve për restaurimin, ruajtjen dhe konservimin e objekteve monument kulture, bazuar në programet dhe prioritetet sektoriale dhe qeveritare.

Monumentet në risk, kthimi i vlerës së investuar, zhvillimi i zonës administrative ku ndodhet monumenti...janë disa nga kriteret në bazë të cilave përcaktohen prioritetet e restaurimeve të monumenteve”.

³² Pika 5. Qëllimi i politikës 2-Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si, çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në bazë të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në nenin 6, të tij, përcaktohet se: “Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Neni 20, në pikat 1, shkronja a) dhe pika 4, e LMD-së, parashikon se:

“ 1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

.... a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

4. Refuzimi, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshin edhe situata kur refuzimi në fakt bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, por nga subjekti diskriminues deklarohen shkaqe të tjera, apo nuk deklarohet asnjë arsye si shkak i refuzimit”.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS³³ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

³³ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

Neni 33, pika 7/1 e LMD, ka parashikuar se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Në aspektin procedural, si fillim pala ankuese duhet të provojë se, i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar është shkaku i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Pra, nëse faktet e prezantuara nga ankuesi duken të besueshme dhe në përputhje me provat në dispozicion, GJEDNJ në praktikën e vet i ka pranuar ato si të provuara, përveçse kur pala tjetër kundër së cilës paraqitet ankesa paraqet një shpjegim alternativ bindës.

GJEDNJ-ja pranon si fakte ato vlerësime “...të mbështetura nga vlerësimi i lirë i të gjitha provave.....provat mund të vijnë nga bashkëekzistenca e deduksioneve/prezumimeve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe të përputhshme apo nga prezumime faktesh të pa kundërshtuara. Për më tepër niveli i bindjes i nevojshëm për arritjen e një konkluzioni të veçantë dhe lidhur me këtë, shpërndarja e barrës së provës, janë të lidhura ngushtësisht me veçoritë e fakteve, natyrën e pretendimit të bërë dhe me të drejtat e pretenduara³⁴”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut/shkaqeve të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të padrejtë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun/shkaqet e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse institucionet respektive, IKTK dhe MK, që pretendohet se kanë konsumuar sjelljen diskriminuese nuk janë në

³⁴ GJEDNJ *Nachova dhe të tjerët v. Bullgarisë* [GC] (Nr. 43577/98 dhe 43579/98), 6.07.2005, para. 147. GJEDNJ, *Timishev v. Rusisë* (Nr.s. 55762/00 and 55974/00), 13.12.2005, para. 39, dhe GJEDNJ, *D.H.dhe të tjerët v. Republikës Çeke* [GC] (Nr. 57325/00), 13.11.2007, para. 178.

gjendje të provojnë njërin nga të dyja, atëherë do të jenë respektivisht përgjegjëse për diskriminimin.³⁵

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, gjatë shqyrtimit dhe konkluzioneve të arritura, në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit nga ana e IKTK dhe MK, lidhur me mosveprime të tyre kundrejt ankuesit, dhe si pasojë barra e provës bie tek këto dy subjekte. Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, IKTK dhe MK duhet të përmbushnin njërin nga dy kushtet e përmendura më sipër.

Bazuar në analizën e mësipërme rezultoi se subjektit ankues, si posedues i banesës ku jeton, shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë, nuk i është garantuar mbrojtja ligjore që ai (për shkak të statusit të banesës) gëzon, përkundrazi është vënë në pozita të pafavorshme duke iu rrezikuar prona, pasi pikërisht për shkak të statusit ligjor si posedues i banesës, e cila mbrohet nga shteti, nuk mund të vijojë apo aplikojë lidhur me procedurat për riparimin apo rikonstruksionin e saj, pavarësisht faktit se banesa rrezikon shembjen. Madje ankuesi ka hasur në pengesa institucionale (mosveprim i insitucioneve) sa i takon të drejtës së tij ligjore për ndërhyrje emergjente për rregullimin e situatës.

Njëkohësisht sa më sipër, rezultoi i provuar e dokumentuar pretendimi i ankuesit se, shkak për trajtimin e tij të padrejtë e të pafavorshëm është bërë pikërisht statusi që ai gëzon si posedues i banesës monument kulture i kategorisë së I-rë. Bazuar në dokumentacionin që disponon nga procedura hetimore, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues e mbart shkakun e sipërpërmendur.

Në rastin konkret argumentet dhe pretendimet e paraqitura nga ankuesi janë në përputhje me provat dhe informacionin e administruar dhe krijojnë prezumimin se mosndërhyrja e insitucioneve përgjegjëse, ka ardhur për shkak të pengesave (kërkesave procedurale) që ata i kanë paraqitur ankuesit, si posedues i banesës, gjë që ka pasuar me mosveprimin e tyre për të ndërhyrë në mënyrë urgjente në banesën për të cilën ata vetë janë dakordësuar e konkluduar (bazuar në aktet e nxjerra nga vetë organet përkatëse përgjegjëse) se rrezikon deri dhe shembjen.

Nga ana e këtyre insitucioneve janë parashtruar para Komisionerit si argumenta se, ankuesi duhet të depozitohet dokumentacionin e nevojshëm, dhe pastaj mund të vijohet me procedurën e mëtejshme për të ndërhyrë në banesën në fjalë.

³⁵ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Bazuar dhe në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, duke iu kthyer rastit të subjektit ankues (dhe pavarësisht faktit nëse ai ka paraqitur apo jo dokumentacionin për provimin e pronësisë mbi banesën, sipas formës së kërkuar nga ligji), ligji ka paraprirë dhe parashikuar edhe rastet kur pronari apo poseduesi i pasurisë së shpallur monument kulture, refuzon, nuk pranon ndërhyrjen në banesën e tij.

Komisioneri shprehet se, legjislacioni ka parashikuar se, në raste të tilla (aq më tepër në këtë rast që ankuesi insiston që të merren masa për ndërhyrje në banesën objekt ankese dhe ia ka bërë të ditur organeve kompetente këtë fakt) është shteti që duhet të ndërhyjë edhe *kryesisht* me iniciativën e tij, kur vlerëson se banesa është në kushtet e nevojës emergjente për ndërhyrje, bazuar në pikën 2, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2028 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

Komisioneri sjell në vëmendje se, hipotetikisht poseduesi apo pronari i banesës monument kulture të mbrojtur nga shteti, mundet të ketë interes apo qëllim ta lërë me vetëdije të degradojë deri në shembje, për qëllime personale, por është *vetë shteti*, që e ka në mbrojtje këtë banesë, që duhet të ndërhyjë qoftë edhe pa miratimin e subjektit privat/pronarit apo poseduesit të banesës, në këtë rast, pasi prevalon interesi publik i ruajtjes së këtij objekti monument kulture i kategorisë së I-rë.

Lidhur me sa më sipër, si dhe në analizë të rastit konkret, Komisioneri gjykon se, ky justifikim i përdorur nga insitucionet përgjegjëse, për mosveprimin e tyre, është haptazi jo i ligjshëm si dhe në kundërshtim me të drejtat ligjore të ankuesit, normuar nga legjislacioni për mbrojtjen e pasurive kulturore/banesave të shpallura monumente kulture të kategorisë së I-rë.

Komisioneri vëren se, e drejta e pronës private është një nga të drejtat themelore të njeriut, si kategori bazike ekonomike-juridike e ndërvarur nga struktura përkatëse politike dhe shoqërore e shtetit. Liria e pronës private është një e drejte kushtetuese e cila garanton paprekshmërinë e pronës privat *nga ndërhyrjet e pajustificuara të organeve shtetërore*.

Në Republikën e Shqipërisë e drejta e pronësisë garantohet nga neni 41 i Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, KEDNJ dhe Protokollit 1 i saj, si dhe rregullohet nga dispozitat e Kodit Civil, si dhe dhe një mori aktesh të tjera ligjore ose nënligjore.

Formulimi i parashikuar në nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë pranon në mënyrë pohuese se e drejta e pronësisë mund të kufizohet. Neni 41 i Kushtetutës, në pikat 2 dhe 3, të tij, përcakton se:

“E drejta e pronës private është e garantuar. 2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil. 3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë”.

Interesi publik nënkupton të mirën publike. Komisioneri vlerëson se, interesi publik, në rastin në fjalë është mbrojtja e ndërtesave të shpallura monumente kulture, të cilat për shkak të kësaj

cilësie kanë fituar këtë status dhe janë sanksionuar në ligj, duke përbërë kështu interes të lartë publik, dhe për shkak të të cilit institucionet përgjegjëse kanë jo vetëm të drejtë por edhe detyrim ligjor mbrojtjen e tyre. Bazuar në vlerat e shumëllojta të tyre dhe autenticitetin që kanë është vlerësuar që ata të gëzojnë këtë status ligjor, si dhe mbrotja e tyre garantohet me ligj, edhe për të siguruar vijimësinë e trashëgiminë e tyre në brezat e ardhshëm. Monumentet e kulturës së një qyteti e kombi janë simbole të rëndësishme që tregojnë vlerat materiale, shpirtërore dhe zhvillimin në shekuj dhe përçimin e tyre në brezat e ardhshëm.

Komisioneri gjykon se, bazuar në sa më sipër, në faktin që këto banesa përbëjnë interes të lartë publik, është detyrim ligjor i vetë shtetit (institucioneve përgjegjëse kompetente) ruajtja, ndërhyrja e mbrojtja e monumenteve të kulturës të shpallura si të tilla, qoftë edhe kryesisht, sidomos në rastet kur vlerësohet se ato rrezikojnë seriozisht të shëmben apo humbin vlerat e tyre për shkak të degradimit të tyre

Për trajtimin diskriminues në pjesën dërrmuese të çështjeve nuk ekzistojnë prova të drejtpërdrejta. Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, IKT dh MK nuk arritën të provojnë me dokumentacion apo prova të tjera që subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme, përse i takon mbrojtjes ligjore që i garanton ligji nr. 27/2028 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, si posedues i banesës monument kulture i kategorisë së I-rë.

Pra në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se, IKTK dhe Mk, nuk kanë provuar se:

Pavarësisht faktit se ata e pranojnë se banesa monument kulture i kategorisë së I-rë “Banesa Xhevdet Lluja”, ka degraduar deri në pikën që rrezikon shembjen dhe rrezikon edhe banesën ngjitur, në një kulm me të, “Banesën Hamid Lluja”, pasuri e subjektit ankues, e cila dhe kjo gëzon të njëjtin status si monument kulture i kategorisë së I-rë, ata kanë marrë masa konkrete, siç ua dikton rasti dhe nevoja, në kushtet e nevojës emergjente për ndërhyrje, bazuar në pikën 2, të nenit 90, të ligjit nr. 27/2028 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”.

Bazuar në qëllimet, objektivin dhe frymën e ligjit nr. 27/2028 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Komisioneri vëren se, institucionet përgjegjëse, duhet të kenë në konsideratë se:

- Bashkëpunimi me pronarët, poseduesit e pasurive monument kulture është i nevojshëm për evidentimin e rreziqeve, problematikave që mund të shfaqen në monumentet përkatëse, duke dhënë, miratuar dhe ndërhyrë me fonde të posaçme.
- Porse, në rastin më të keq, mungesa e bashkëpunimit nga ana e pronarit, poseduesit, mossinjalizimi dhe mosparaqitja e dokumentacionit të objektit (siç thuhet i rifreskuar),

apo dëshmia e trashëgimisë, akti i pjesëtimit të banesës, për shkaqe objektive e subjektive etj, nuk duhet të përbëjë kusht për mosdhënien e fondit për mirëmbajtjen e objektit monument kulture.

Institucionet përgjegjëse, kryesisht, pa vullnetin e pronarit a poseduesit, pa dokumentacionin e plotë apo me dokumentacion të mangët të pronësisë, pa sinjalizim, pa lajmërim dhe pa aplikim, e ka për detyrë funksionale që:

- të verifikojnë e mbikëqyrin çdo monument kulture, gjendjen e tij dhe nevojën për ndërhyrje (nëse ka);

- të miratojnë fondin përkatës për shmangien e dëmtimit të objektit monument kulture.

Së fundmi, kushti i vetëm për të miratuar fondin për ndërhyrjet në objektin monument kulture sipas ligjit nr. 27/2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, është që: sipas akt konstatimeve të organeve përkatëse, objekti të paraqesë nevojë për punime mirëmbajtjeje e aq më tepër kur lind nevoja për ndërhyrje emergjente, siç është rasti objekt shqyrtimi pranë KMD-së.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankuesit i është cënuar e drejta e pronës, e drejtë kjo e mbrojtur drejtëpërdrejtë nga ligji, pasi nga mosveprimi i organeve përgjegjëse për të ndërhyrë në banesën *“Xhevdet Lluja”*, rrezikohet edhe banesa e tij ndodhur në një kulm me të.

E drejta e pronës buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Në kushtet kur ndalimi i diskriminimit është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t’u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet, është një e drejtë e sanksionuar dhe e mbrojtur shprehimisht me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, është e natyrshme që kjo e drejtë vendos detyrime mbi çdo institucion përgjegjës, të ndërmarrë veprime në përputhje me të drejtën e personave/subjekteve për mbrojtjen nga diskriminimi.

Komisioneri thekson faktin se, mbrojtja e trashëgimisë kulturore nuk duhet trajtuar si çështje e aplikimit të individit (pronar apo posedues qoftë ai), për t’u trajtuar me fonde objekti, por si kujdes e detyrim funksional i shtetit/institucioneve përgjegjëse, që përtej formalitetit e teknikaliteteve, është/janë përgjegjës/e për ruajtjen e trashëgimisë kulturore.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, trajtimi i padrejtë e i pafavorshëm i subjektit ankues, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se IKTK dhe MK, kanë diskriminuar subjektin ankues, pasi me mosveprimin e tyre (si dhe mungesën e bashkëveprimit e koordinimit ndërinstytucional) nuk kanë garantuar mbrojtjen ligjore që ai (si posedues i banesës) gëzon, përkundrazi e kanë vënë në pozita të pafavorshme duke bërë që atij t’i rrezikohet prona. Pikërisht për shkak të statusit ligjor të tij si

posedues i banesës, monument kulture i kategorisë së I-rë, e cila mbrohet nga shteti, ai nuk mund të vijojë me ndjekjen e një procedure të posaçme, për riparimin apo rikonstrukcionin e saj, pavarësisht faktit se banesa rrezikon shembjen.

Për rrjedhojë institucionet e IKTK dhe MK, kanë shkelur dispozitat e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, respektivisht: nenin 3, pikat 1 dhe 2, dhe nenin 20, pika 1, shkronja a, dhe pika 4 e tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.

LMD, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ky ligj, përmes nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri, në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e mosndërhyrjeve në banesën në fjalë, në rrezik shembjeje, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur, duke e marrë masat për ndërhyrje urgjente në mënyrë që ajo të mos degradojë më tej dhe të shembet, gjë që do të rrezikonte të dyja banesat në një kulm, njëherazi.

Mbrojtja nga diskriminimi e garantuar nga ligji nuk do të ishte efektive nëse subjektet për të cilat është konstatuar se kanë shkelur dispozitat e LMD-së, nuk do të ndërmerren masat efektive për të ndrequr pasojat e ardhura për shkak të veprimit apo mosveprimit të tyre.

LMD, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij, duke sanksionuar se: “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar si pasojë e mosveprimit është të ndërhyrë në banesat në fjalë monumente kulture, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur duke marrë masat e menjëhershme për të ndërhyrë efektivisht në banesat në fjalë, të cilat gëzojnë status dhe mbrojtje të posaçme ligjore nga vetë shteti.

C. 2 Lidhja e trajtimit të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë me “përkatësinë e ankuesit në një grup të veçantë”.

Mbështetur në analizimin e fakteve e provave të depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se subjekti ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë e të pafavorshëm, nga ana e institucioneve përgjegjëse, IKTK dhe MK, përse i takon mosveprimi të tyre dhe mungesës së bashkëveprimit mes tyre me eficescë, lidhur me koordinimin dhe marrjen e masave të menjëhershme dhe efektive, për të ndërhyrë në banesën me status të veçantë, monument kulture i kategorisë së I-rë “Banesa Xhevdet Lluja”, lidhur me ndalimin e degradimit të mëtejshëm dhe ndërhyrjen për rikonstruksionin e nevojshëm e të detyruar të saj, gjë e cila ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë e është e ndërlidhur edhe me sigurinë e kushtet teknike të banesës së ankuesit, “Banesa Hamid Lluja”, si të dy banesa këto ndodhur në një kulm të përbashkët.

Nga ana e IKTK dhe MK, nuk u sollën prova dhe nuk u dokumentua që ata të kishin vepruar apo ndërmarrë masa konkrete, për të ndërhyrë për zgjidhjen e problematikës së ngritur.

Përkatësia në një grup të veçantë e ankuesit, si ish i përndjekur politik, dhe i dënuar e dëbuar për çështje politike, nga viti 1983-1988, gëzon mbrojtje ligjore si shkak i parashikuar në LMD, mirëpo, gjatë procedurës hetimore të shqyrtimit të ankesës nuk u arrit të provohej që pikërisht ky shkak kishte shërbyer si shkak që ai të ishte trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme nga institucionet sipërpërmendur.

Njëherësh Komisioneri evidenton deklarinimin e bërë nga vetë subjekti ankues gjatë seancës dëgjimore, që në dijeninë e tij, ka dhe familje të tjera në Shkodër, banesat e të cilave gëzojnë statusin monument kulture i kategorisë së I-rë, që pronarët apo poseduesit e tyre kanë të njëjtin status si ai, atë të të përndjekurit politik, dhe banesat e tyre u janë nënshtruar ndërhyrjeve, mirëmbajtje apo rikonstruksione, nga ana e instancave përgjegjëse.

Për rrjedhojë, KMD vlerëson se, pretendimet e ankuesit për diskriminim bazuar në këtë shkak, nuk krijojnë prezumimin mbi bazën e provave të drejtëpërdrejta apo të tërthorta të sjella prej tij, që sjellja e institucioneve përkatëse, konkretisht IKTK dhe MK, kundrejt tij të jetë motivuar nga shkak sipërcituar.

Sa më sipër Komisioneri nuk arriti të provojë se trajtimi i padrejtë e i pafavorshëm i ankuesit, nga ana e MK dhe IKTK, të kishte ardhur për shkakun sipërcituar (për shkak të statusit të ankuesit si ish i përndjekur politik/përkatësi në një grup të veçantë).

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 1, nenin 3, pikat 1 dhe 2, nenin 7, nenin 20, pika 1, shkronja a), e pika 4, nenin 32, shkronja a), si dhe nenin 33, pikat 7/1, 10, 11 dhe 12, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të subjektit ankues, F. Ll, në fushën e të mira dhe shërbimeve, për shkak të statusit të veçantë ligjor që gëzon ai, *si posedues* i banesës monument kulture i kategorisë së I-rë, nga ana e Ministrisë së Kulturës (MK) dhe Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kombëtare (IKTK).
2. Në referim të pikës 1, institucionet përgjegjëse MK dhe IKTK, të marrin masa efektive për ndërhyrjen urgjentisht në banesat e shpallura monument kulture të kategorisë së I-rë, “Banesa Xhevdet Lluja” dhe “Banesa Hamid Lluja”, sipas nevoja specifike.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, MK dhe IKTK, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, F. Ll, në fushën e të mira dhe shërbimeve, për “shkak të përkatësisë në një grup të veçantë³⁶”, nga ana e Institutit Kombëtar i Trashëgimisë Kombëtare, Ministrisë së Kulturës dhe Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

³⁶ Subjekti ankues bazuar në dokumentacionin e depozituar gëzon statusin e të përndjekurit politik, si dhe provon faktin se ka qenë i dënuar e dëbuar për çështje politike, nga viti 1983-1988, sipas Vendimit të Komisionit Qendror të Internim Dëbimeve me nr. 12, datë 05.11.1983

